



Miratar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 58, datë 10/03/2021

## Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikualve dhe Cilësisë

### Neni 1

#### Baza ligjore

Rregullorja për funksionimin Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (poshtë referuar si NJZHKC), mbështetet në Ligjin nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë" në fuqi, mbi Statutin dhe Rregulloren akademike të Universitetit Barleti.

### Neni 2

#### Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton mënyrat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji i Arsimin të Lartë, Kodi i Cilësisë dhe standardet e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimin të Lartë (HEAL), me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.

Kjo rregullore zbatohet në gjithë universitetin, ndryshohet e përmirësohet kohë pas kohe, sipas kontekstit, nevojave dhe kërkesave dhe miratohet nga Senati i UniBa.

### Neni 2

#### Parimet e vlerësimit

- a. Vlerësimi konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet kombëtare dhe europiane të cilësisë.
- b. Vlerësimi kryhet duke zbatuar parimin e autonomisë institucionale.
- c. UniBa e përdor vlerësimin për të:
  - (i) përcaktuar nivelin e cilësisë së arritur;
  - (ii) evidentuar praktikatat pozitive;
  - (iii) sjellë përmirësime, ndryshime dhe zhvillime pozitive;
  - (iv) marrë vendime.
- d. Vlerësimi kryhet në çdo aspekt të veprimtarisë institucionale, mësimore, kërkimore, e administrative.
- e. Metodatat e vlerësimit duhet të demonstrojnë një balancë të metodave sasiore dhe cilësore dhe të të dhënave të vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm, të vlerësimit formues dhe përmbledhës si dhe një llojshmëri instrumentesh.
- f. Metodatat e vlerësimit përputhen me misionin, qëllimin dhe objektivat e UniBa.
- g. Vlerësimi mbështetet në një shumëllojshmëri burimesh.
- h. Studentët janë pjesëmarrës në vlerësim. Ata marrin pjesë nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, nëpërmjet pjesëmarrjes në intervista, fokus grupe dhe në ekipe të vlerësimit.
- i. Formularët dhe pyetësorët e vlerësimit që plotësohen prej studentëve janë anonimë.
- j. Rezultatet e vlerësimit duhet të jenë të dobishme për studentët që studiojnë në UniBa, për të gjithë ata që punojnë në UniBa, për institucionet dhe publikun e interesuar.
- k. Çështja më e rëndësishme në zhvillimin e vlerësimit është krijimi i kulturës së vlerësimit. Të gjitha palët duhet të jenë përgjegjëse dhe të ndihmojnë për krijimin e kësaj kulture.
- l. Vlerësimi është një proces sistematik.
- m. Vlerësimi bazohet në standardet e përcaktuara.
- n. Vlerësimi kërkon të sigurohen të dhëna të besueshme dhe të vlefshme.

- o. Vlerësimi është një piketë për reflektim kritik dhe një vlerë qëndrore gjatë vendimmarrjeve strategjike.

### Neni 3

#### **Komisioni i Sigurimit të Cilësisë**

Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është një organizëm që ngrihet dhe funksionon në nivel institucioni është organ kolegjal i llojit komision i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim dhe mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. KSSC mbështet Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë për të përmbushur funksionet e saj lidhur me përmbushjen e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.

KSSC përbëhet nga 5 anëtarë të propozuar nga Rektori dhe të emëruar nga Senati, për një afat 2 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e komisionit duhet të përfaqësojnë strukturat akademike dhe ato administrative të nivelit të lartë dhe /ose të kenë përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë.

Një nga anëtarët e komisionit është përfaqësues nga qeveria studentore. KSSC çdo fillim viti akademik përgatit planin e punës për vitin akademik në vijim. Në fund të vitit akademik raporton në Senat dhe jep vlerësimet për arritjet, sfidat e hasura dhe rekomandimet për zhvillimin e kulturës së cilësisë në UniBa.

### Neni 4

#### **Struktura e Njësisë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC)**

Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë është njësi e pavarur në nivel institucioni që ka si qëllim monitorimin, vlerësimin dhe zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së UniBa. NJZHKC përbëhet nga Drejtuesi i Njësisë dhe tre koordinatorë.

---

### Neni 5

#### **Funksionet kryesore të NJZHKC**

#### **Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.**

- a) Në bashkëpunim me Zv. Rektorin Akademik ideon dhe organizon proceset e monitorimit të aktiviteteve mësimore
- b) Organizon në fund të çdo semestri pyetësorin me studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
- c) Organizon fokus grupe me studentët në nivel fakulteti për të kuptuar në thellësi vlerat dhe sfidat e procesit mësimor sipas perspektivës së studentëve.
- d) Në bashkëpunim me Zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor përcaktojnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të veprimtarive kërkimore shkencore.

### Neni 6

#### **Zhvillimi i kurrikulave**

- a) Orienton dhe këshillon njësitë bazë lidhur me hartimin, riorganizimin dhe përmirësimin e kurrikulave në UniBa.
- b) Realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga UniBa.



- c) Përditësimi dhe zhvillimi i kurrikulave dhe procedurat që duhet të ndiqen janë parashikuar në manualin e procedurave.

## Neni 7

### Ruajtja e standardeve të sigurimit të cilësisë

- a) Formulon rekomandime dhe sugjerime lidhur me organizimin e procesit mësimor me qëllim ruajtjen dhe garantimin e sigurimit të cilësisë.
- b) Harton standardeve dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë që zbatohen në UniBa, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

## Neni 8

### Ndjekjen e proceseve të akreditimit.

- a) Propozon ndryshime në funksion të garantimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe aktet nënligjore.
- b) Harton kalendarin e akreditimeve
- c) Organizon, ndjek dhe koordinon proceset e akreditimit në bashkëpunim me njësitë e tjera institucionale
- d) Përditëson të dhënat në sistemin e ASCAL

## Neni 9

### Format e vlerësimit mëyra e mbledhjes së të dhënave

Vlerësimi bazohet në shumëllojshmëri burimesh dhe të dhënash. Si burim për vlerësim shërben informacioni i mbledhur nga studentët, nga kolegët, nga drejtuesit, nga ekipet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Të dhënat grumbullohen duke përdorur një shumëllojshmëri instrumentesh.

Në listën e instrumenteve që përdoren për monitorim dhe vlerësim përfshihen: pyetësorë, formularë vlerësimi, formularë vetëvlerësimi, intervista, fokus grupet, skeda vrojtimi, raporte. Vlerësimi bazohet në një shumëllojshmëri të dhënash sasiore dhe cilësore.

NJZHKC ka hartuar një sërë proceduras për përmbushjen e funksioneve të saj që gjenden në të detajuara në Manualin e Procedurave të Njësisë Ky manual është objekt rishikimi dhe përmirësimi të përvitshëm.

## Neni 10

### Raporti dhe pbllokimi i të dhënave

NJZHKC harton raportin vjetor të të dhënave mbledhur nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit parashikuar në funksionet e njësisë. Raporti vjetor i vlerësimit publikohet në faqen elektronike zyrtare të UniBa dhe bëhet publik për stafin dhe studentët edhe në sistemin e brendshëm të Unievrstitetit në INTRANET.

Raport e vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programeve të studimit dhe akreditimin institucional publikohen në faqen e UniBa.

## Neni 11

### Ndryshimet/ Shtesat e Rregullores

- a) Ndryshimet e kësaj rregulloreje hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të "Universitetit Barleti".

- b) Çdo ndryshim i Rregullores propozohet nga strukturat drejtuese akademike të “Universitetit Barleti ” dhe miratohet nga Senati Akademik.
- c) Senati Akademik ka te drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje.

**Për Senatin e Universitetit “Barleti”**

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Agim KUKELI**

